



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë
Mbledhja nr. 81
Prishtinë, më 24.4.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Adelina Grainca, Yllza Hoti, Ariana Musliu-Shoshi, Doarsa Kica-Xhelili dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Xhavit Haliti, Gazmend Gjyshinca, Fitore Pacolli-Dalipi dhe Bahrim Shabani.

Të pranishëm në takim: z. Jonathan Hargreaves, ambasador i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, me bashkëpunëtorët Richard Le Vay dhe Hereze Sefaj.

Pjesëmarrës të tjerë: Jon Limaj, QKSS; Blendi Gashi, Leudita Mejzini, Alisa Thaçi, Besarta Pllana, Adriana Osmani, Kuvend; Medina Ismaili, praktikante Kuvend; Drin Podrimqaku, GP-LVV; Liridona Gashi, Kabinet, Kuvend; Anila Januzi, GP-LDK.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi Arbëreshë Kryeziu- Hyseni, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

Takim i komisionit me z. Jonathan Hargreaves, ambasador i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, e uroi z. Jonathan Hargreaves për detyrën e tij të re, si ambasador i Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Kosovës, si dhe shtoi se ambasadori do të ketë mundësi të ndërtojë bashkëpunim të mirëfilltë me përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës dhe të ndërtojë të njëjtin raport, të cilin Britania e Madhe e ka pasur ndër vite me Republikën e Kosovës. Bëri të ditur se një delegacion i këtij Komisioni ishte në vizitë zyrtare në Britaninë e Madhe, e cila ka qenë shumë e mirë dhe e suksesshme dhe falënderoi përfaqësuesit e ndryshëm të institucioneve në Britaninë e Madhe që kanë gjetur kohë për t'u takuar dhe për të diskutuar për aktualitetin në Kosovë dhe për të marrë përkrahjen e pazezervë, të cilën asnjëri prej tyre nuk ka hezituuar ndonjëherë që ta thotë edhe publikisht. Gjatë kësaj vizite, tha se Komisioni është takuar edhe me përfaqësuesit britanikë në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, të cilët premtuan se përpos që unanimisht do të votojnë për Kosovën, do të jenë lobues të jashtëzakonshëm tek të gjitha shtetet dhe anëtarët, ku ata mund të kenë

ndikim. Raportet bilaterale në mes të dy vendeve, tha se janë të shkëlqyeshme dhe se Kosova është falënderuese ndaj Britanisë së Madhe, për përkrahjen e saj, dhënë për anëtarësimin e Kosovës në BE e anëtarësimin e Kosovës në organizata të ndryshme ndërkombëtare, por po ashtu edhe sa i përket shtimit të trupave të KFOR-it, në kohën kur Republika e Kosovës ka pasur nevojë që të rrisë masat e saj të sigurisë.

Jonathan Hargreaves, i falënderoi anëtarët e Komisionit për ftesën dhe shprehu mendimin se Kosova është vendi më i mirë për të qenë ambasador britanik, sepse ka një miqësi të shkëlqyer, për shkak të mikpritjes, të cilën e ka përjetuar dhe për shkak të gjithë punës së rëndësishme që bëhet së bashku. Tha se raporti ndërmjet dy vendeve shkon shumë larg në histori dhe përtej fillimit të Kosovës, si një shtet i pavarur dhe është krenar për raportin e ndërtuar me Kosovën. Duke iu referuar deklaratave të ministrit të Jashtëm të Britanisë, tha se Britania është e përkushtuar ta mbështesë Kosovën në konsolidimin e pavarësisë dhe sovranitetit dhe të merr vendin e merituar në komunitetin e kombeve të ndryshme. Ai shtoi se Britania do të forcojë edhe më tej kontributin e saj, sidomos në fushën e sigurisë, që është thelb i këtij raporti ndërshtetëror. Të rëndësishme i cilësoi edhe lidhjet ekonomike dhe kulturore, të cilat duhet të zhvillohen tutje dhe të ndërtohet një themel i fortë mbi këto lidhje.

Ariana Musliu-Shoshi, e falënderoi ambasadorin për praninë e tij në mbledhjen e Komisionit. Bëri të ditur se si anëtare e delegacionit të Kuvendit në Këshillin e Evropës, ka pasur shumë takime dhe Britania e Madhe e ka ndihmuar Kosovën, gjatë gjithë rrugëtimit, mirëpo shtoi se nuk është e sigurt se çfarë ka ndodhur me votimin e fundit, ku nga 18 anëtarë, tre kanë votuar për, njëri ka qenë kundër dhe njëri ka abstenuar. Ajo tha se Kosova për të qenë anëtare e plotë e KE-së, është dërguar edhe një letër nga Presidentja, Kryeministri dhe ministrja e Punëve të Jashtme, përmes së cilës janë përkushtuar për implementimin e Asociacionit të komunave serbe dhe çështjet e tjera. Më tej, shtoi se komuniteti ndërkombëtar është i shqetësuar me Qeverinë e Kosovës, kur bëhet fjalë për integrimin në organizata ndërkombëtare dhe shpreson se Kosova do ta ketë mbështetjen e Britanisë dhe ndikimin që ka te vendet tjera të BE-së, në mënyrë që anëtarësimi i Kosovës të jetë i suksesshëm. Njoftoi se ka një shqetësim nga Italia dhe Franca dhe nevojitet një përkushtim serioz nga Qeveria, në zbatimin e asociacionit, nëse dëshiron që të hyjë në agjendën Komitetit të Ministrave dhe të marr votat “për”, që të bëhet anëtar me të drejta të plota në Këshillin e Evropës. Pyeti ambasadorin se cili është qëndrimi i tij, sa i përket kësaj çështjeje dhe shtoi se është në dijeni se ky shqetësim është ndarë edhe nga Britania, si vend.

Jonathan Hargreaves, theksoi se Britania e Madhe është mbështetëse për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës dhe është duke punuar shumë që të arrihet kjo. U shpreh se janë të lumtur, lidhur me zbatimin e vendimit për Deçanin, i cili është një hap i duhur për ta mundur anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë. Më tej, theksoi se i mbështet veprimet që i ka ndërmarrë Kosova, për t'i mbrojtur pakicat dhe të drejtat e njeriut, siç është theksuar edhe në raportin e zj. Bakoyannis. Shprehu mendimin se tani është koha që Kosova të bëjë gjithçka që është e mundur, për të për t'u bërë anëtare e Këshillit të Evropës dhe nuk do të ketë momentum më të mirë se tani për anëtarësimin e Kosovës. Po ashtu, këshilloi që Kosova të shënojë progres, sa i përket asociacionit të komunave serbe, sepse ajo se çfarë të gjithë dëshirojnë, është të ketë votim të suksesshëm në Komitetin Ministror. Mungesa e anëtarëve britanikë në Asamblenë Parlamentare, tha se ishte një fatkeqësi, dhe njoftoi se ata kanë pasur një agjendë të ngjeshur, si parlamentarë. Në vijim, tha se Kosova tani duhet të bëjë progres të qartë, dhe nëse kjo ndodhë, atëherë do të ketë një mundësi të madhe për votim të suksesshëm në Komitetin Ministror, por të gjithë mund të pajtohen se një votë jo e suksesshme do të ishte një fatkeqësi e madhe dhe do të kthejë procesin prapa në kohë.

Ariana Musliu-Shoshi, tha se sa i përket të drejtave të njeriut, sidomos Kodit civil, siç janë të drejtat e LGBTQ+, tha se ata dëshirojnë që kjo të zbatohet sa më parë, por jo si parakusht. Asociacioni duket nga

të gjitha diskutimet që janë bërë deri tani, është një gjë që nuk mund të zgjidhet aq lehtë, por është si një pjesë e parakushtit. Sa i përket vendimit për Manastirin e Deçanit, theksoi nga të gjitha partitë kanë thënë se nuk duhet të flasim për këtë vendim, sepse duhet të kalohet, pasi që duhet të kemi votën në Asambleenë Parlamentare. E njëjta gjë vlen edhe për asociacionin. Kosovës i duhen hapa konkretë, në mënyrë që të anëtarësohet, si anëtare me të drejta të plota dhe nuk ka kohë më të përshtatshme, që të arrihet progres në këtë çështje të rëndësishme, për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe Kosovën.

Time Kadrijaj, tha se raportet e Kosovës me Mbretërinë e Bashkuar janë shumë miqësore dhe nuk është e tepërt të falënderohet për gjithë përkrahjen që ia ka ofruar Kosovës, në të gjitha fazat. Theksoi se Kosova ka vetëm një orientim, që është anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe prej vendeve të rajonit, Kosova është më e përkushtuar në këtë rrugëtim sesa vendet e tjera. Më tej, shtoi se duke u bazuar në situatën gjeopolitike, edhe në situatën e sigurisë, është kërkesë legjitime e Kosovës për të qenë pjesë e NATO-s. Më tej, tha se ky është një rrugëtim i gjatë, që kërkon kohë, por duke marrë parasysh vendet si Suedia dhe Finlanda, që u anëtarësuan me procedura të përshtepjuara, do të kishte qenë mirë që edhe Kosova, me procedurë të përshtepjuar, të jetë pjesë e NATO-s.

Jonathan Hargreaves, tha se sa i përket anëtarësimit të Kosovës në BE, kjo çështje i takon BE-së dhe Mbretëria e Bashkuar nuk është pjesë e procesit të vendimmarrjes, por theksoi se do ndajnë me kolegët e tyre në BE, vëmendjen për dialogun. Bëri të ditur se janë këtu për ta mbështetur Kosovën, në mënyrë që të ketë progres në rrugëtimin e saj dhe gjithashtu bëri të ditur se do t'i shfrytëzojnë raportet e tyre me Serbinë, që të inkurajohet edhe ajo, për t'i bërë detyrat e saj lidhur me zbatimin e marrëveshjes bazike dhe aneksit. Sa i përket anëtarësimit në NATO, ambasadori theksoi se ka vende në NATO që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës dhe mënyra më e mirë për të përshtepjuar progresin drejt anëtarësimit, është që të binden ato vende se Kosova i ka kryer të gjitha detyrat. E vlerëson rolin e Kosovës dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në mbështetjen e Ukrainës, në aspekte praktike dhe duke iu bashkuar operacionit, i cili është duke i trajnuar ushtarët e Ukrainës.

Yllza Hoti, sa i përket bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar, në aspektin kulturor, ekonomik dhe arsimor, tha se roli i ambasadorit në këtë aspekt do të ishte shumë i dobishëm, sepse Ambasada e Britanisë, gjithmonë ka qenë bashkëpunuese, duke ofruar mbështetje për komunitetin lokal dhe duke u ofruar mundësi të rinjve. Lidhur me këtë, shprehu mendimin se bashkëpunimi në sferën ekonomike, duke ndërtuar një urë lidhëse ndërmjet investitorëve në Britani dhe ndërmarrësve në Kosovë, do të ishte shumë i rëndësishëm. Theksoi se Mbretëria e Bashkuar ka bërë një punë të madhe në Kosovë, duke ofruar bursa për studentët. Kjo është një mundësi e mirë që të forcohen më tej raportet dhe të ketë njerëz nga Kosova që shkojnë në Britani të Madhe dhe të marrin përvojë nga jetesa aty dhe do të ishte mirë që të shohim edhe njerëz nga Britania, që vijnë në Kosovë, për të ofruar ekspertizën e tyre në fusha të ndryshme dhe të shohin se si duket jeta në Kosovë, pasi që mënyra se si paraqitet Kosova, nuk mund të jetë ajo se siç është në realitet.

Jonathan Hargreaves, sa i përket bashkëpunimit në fushën e ekonomisë, kulturës dhe arsimimit, tha se ka potencial të madh për bashkëpunim. Pajtohet se kjo do të ishte një mundësi e mirë që t'ju tregohet të gjithëve se Kosova nuk është ajo që ndoshta mendojnë njerëzit në Evropë. Lidhur me bashkëpunimin ekonomik, theksoi se shifrat e tregtisë ndërmjet dy vendeve janë të ulëta dhe është i interesuar për ta përmirësuar këtë, pasi që ka shumë mundësi për të investuar në Kosovë. Njoftoi se Ambasada ka programe për t'i ndihmuar kompanitë e Kosovës, që të kenë më shumë sukses në eksport dhe se ekziston mundësia nga të dy anët për promovimin e investimeve. Bëri të ditur se pjesë e punës së Ambasadës është edhe dhënia e ndihmës kompanive të interesuara, për të investuar në Kosovë, duke i njoftuar me procedurat, pengesat për të arritur një investim të suksesshëm. Po ashtu, tha se Kosova ka një diasporë aktive, si në vendet e BE-së, ashtu edhe në Mbretërinë e Bashkuar, e cila duhet të shfrytëzohet, në mënyrë

që të luajë një rol të rëndësishëm ekonomik. Sa i përket fushës së arsimit, njoftoi se Këshilli Britanik në Kosovë ka një prezencë virtuale, janë shumë aktivë dhe janë duke punuar për të zhvilluar industrinë kreative.

Doarsa Kica-Xhelili, duke iu referuar votimit të deputetëve britanikë në Asambleenë Parlamentar të KE-së, tha se nuk ka marrë informacion të saktë se cili ka qenë disponimi gjatë vizitës së Komisionit në Britani të Madhe dhe çfarë është diskutuar gjatë këtyre vizitave, pasi që ka pasur një bojkot të brendshëm për dy pjesëtarët e Komisionit, që të marrin pjesë në këtë vizitë. Sa i përket draftit, të cilin e kanë pranuar nga shtetet e kuintit, tha se të njëjtin e kanë analizuar në detaje dhe kanë disa shqetësime të mëdha, lidhur me këtë draft. Gjatë leximit të këtij draft-statusi, tha se ka hasur në rreziqe të mëdha brenda këtij drafti. Tha se është në dijeni që nuk ka pasur ndonjë mendim të keq, por mund të jetë edhe mënyra e të kuptuarit në aspektin kushtetues të vendeve të ndryshme, sepse asnjë i huaj nuk mund ta kuptojë kornizën kushtetuese të Kosovës, më mirë sesa ekspertët e brendshëm. Shtoi se do ta analizojnë më tej draft-statutin dhe kërkoi që ky draft të diskutohet edhe me kolegët e ambasadorit, në mënyrë që të kuptohet qartë se si është lexuar draft-statuti nga ajo dhe rrezikun që është paraparë, nëse do të implementohet në mënyrën se siç është hartuar. Në vijim, tha se drafti është shkruar në një aspekt tipik për BE-në, ka shumë dualizma, ka shumë mundësi të interpretimeve të ndryshme. Njoftoi se në raportin e “Freedom House” janë përmendur disa nga skandalet korruptive të qeverisë aktuale, një nga to tha se është edhe shkarkimi i shefit të Njësisë Speciale Investigues dhe dy policëve të përfshirë në këtë hetim, të cilët janë shkarkuar menjëherë, pasi që disa anëtarë të korporatës energjetike KEK janë ndaluar. Lidhur me këtë, tha se kjo është një gjë urgjente për t’u analizuar, në aspektin e korrupsionit, por edhe të demokracisë. Perceptimi i qytetarëve të Kosovës për Britaninë e Madhe, tha se është i paprekur, është i njëjti siç ishte më parë dhe e ftoi ambasadorin të vizitojë zyrën e LDK-së, për të diskutuar për mundësitë më të mira të bashkëpunimit. Në fund, shtoi se duhet të shikohen mundësitë e inkuadrimit të diasporës së Kosovës në Britaninë e Madhe, për hapjen e bizneseve të tyre dhe të shfrytëzohen njerëzit e Kosovës, që të punojnë në sektorin e TI-së.

Jonathan Hargreaves, lidhur me draft-statusin, tha se kjo varet nga qeveria se cilin version vendos ta dërgojë në Gjykatën Kushtetuese dhe të marrë obligime nga ajo. Ai shtoi se nuk është përgjegjësi e tij që të flas për përmbajtjen e draftit, por këshillon që qeveria ta dërgojë në Gjykatën Kushtetuese, në mënyrë që Kosova të ketë progres në Këshillin e Evropës dhe në dialog. Sa i përket çështjes për shkarkimet, tha se nuk i ka faktet dhe nuk mund të komentojë rreth këtyre shkarkimeve. Është i interesuar për rolin e diasporës në sektorin e teknologjisë informative dhe ka dëgjuar se Kosova mund të ketë një përparësi të madhe në këtë sektor, pasi që ka një rini fantastike, që është një potencial enorm. Bëri të ditur se ka avoukar shumë për rolin e grave në shoqërinë kosovare dhe është i impresionuar, duke parë që shumica e anëtarëve të Komisionit janë gra. Në fund, tha se kjo tregon se sa të fuqishme mund të jenë gratë në Kosovë dhe sa të përkushtuara mund të jenë për të ardhmen e Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni

Kryetare e Komisionit